



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 219/3 Prot.

Tiranë, më 8.04.2016

REKOMANDIM

Nr. 06 datë 8.04.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ngarkim të kontrolluesit klinika "Intermedica Center" sh.p.k. me formë ligjore të aktivitetit person juridik,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr.40, datë 22.02.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u realizua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit klinika "Intermedica Center" sh.p.k., me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit klinika "Intermedica Center" sh.p.k. i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Gjatë kryerjes së veprimeve administrative procedurale pranë këtij kontrolluesi, grupi i kontrollit konstatoi se:

Kontrolluesi klinika "Intermedica Center" sh.p.k., ushtron aktivitet në fushën e shëndetësisë, sektorin klinik dhe kryen analiza Biokimike, Klinike, Immunologjike, Hormonale etj.

1. Nga verifikimi i bërë në regjistrin elektronik të subjekteve kontrollues të cilët kanë njoftuar pranë zyrës së K.D.I.M.D.P.-së, (referuar nenit 21 dhe 22 të ligjit), konstatohet se ky kontrollues e ka kryer detyrimin për "Njoftim". Nga verifikimi i "Njoftimit" të bërë pranë K.D.I.M.D.P.-së, konstatohet se kontrolluesi nuk ka deklaruar në lidhje me përhapjen e të dhënave të pacientëve drejt palëve të treta, si dhe qëllimin e përhapjes së këtyre të dhënave.

Referuar nenit 22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", njoftimi duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe adresën e kontrolluesit;
- b) qëllimin e përpunimit të të dhënave personale;

- c) kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe kategoritë e të dhënave personale;
- ç) marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave personale;
- d) propozimin për transferimet ndërkombëtare që kontrolluesi synon të kryejë;
- dh) një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi ka "*Akt Marrëveshje*" me palë të treta si me "*Intersig VIG sh.a*" dhe "*Sigma Inter-Albanian VIG sh.a.*".

Objekti i Kontratave të Bashkëpunimit, rregullon të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellëta të palëve në lidhje me shërbimet mjekësore që do të ofrohen nga Klinika Intermedica Center dhe që mbulohen nga kompania e sigurimit respektive.

Parë në frymën e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", nenet 27 dhe 28 të tij, konkludohet se aktmarrëveshjet nuk janë në përputhje me Udhëzimin Nr. 19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve midis kontrolluesit dhe përpunuesit...*".

Duke qenë se sistemi shëndetësor është tepër i ndjeshëm në fushën e të dhënave personale, përpunimi i të dhënave personale shëndetësore të kategorizuara në ligj si "*të dhëna sensitive*", merr rëndësi jashtëzakonisht të veçantë. Marrja e masave të përshtatshme në përputhje me detyrimet ligjore që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 i ndryshuar, nuk mund të jenë të nënkuptuara apo të përgjithshme. Ato duhet të jenë të posaçme në funksion të përpunimit të ligjshëm dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Vendimet, udhëzimet, rregulloret organizative, deklaratat e konfidencialitetit, marrja e pëlqimit, informimi etj., duhet të jenë të plota, të shprehura, të detajuara dhe të aplikueshme.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e shëndetësisë.

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 9887 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi të përditësojë "*Njoftimin*", në lidhje me konstatimet e pikës së parë, duke sjellë në vëmendje se përditësimi është një proces në vazhdimësi dhe si i tillë të mos neglizhohet.
2. Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve midis kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip, në rastet e këtij delegimi*", kontrolluesi "*Intermedica Center*" sh.p.k. të hartojë aneks kontratat, sipas standardeve të shprehura në aktet e dala nga Komisioneri, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve "*pacientë*".
3. Detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, kontrolluesi "*Intermedica Center*" sh.p.k., duhet ti realizojë brenda afatit kohor prej 30 ditësh.

4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI
